



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3209/11 Prot.

Tiranë, më 18/12 /2024

V E N D I M

Nr. 41 datë 18.12.2024

P Ë R

**MËNYRËN E NDARJES SË TË ARDHURAVE NDËRMJET EKSPERTËVE,
PERSONEL AKADEMIK, QË ANGAZHohen NË SHËRBIMIN E OPOENCave
TEKNIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja “a” dhe “c”, neni 49, pika 1, shkronja “ë”, neni 109, pika 2, VKM nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektin që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, pika 5 e vendimit nr. 188, datë 13.03.2019 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë, të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, të ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës neni 10, pika 2, shkronja “e”, Vendimin nr. 15, datë 24.04.2020 “Për miratimin e rregullores për “Disiplinimin e sistemit të shërbimeve në UPT”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe në relacionin nr.3209 prot., datë 13.12.2024 të Administratorit të Institucionit,

VENDOSI:

1. Propozimi i administratorit të institucionit, për ndarjen e të ardhurave ndërmjet ekspertëve personel akademik që angazhohen në shërbimin e oponencave teknike sipas përcaktimeve të VKM nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektin që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, të paraqitet për mendim pranë njësive bazë dhe njësive kryesore, fusha e veprimit të cilave përfshihet në përcaktimet e këtij akti nënligjor;
2. Deri në marrjen e një vendimi tjetër, ndarja e të ardhurave ndërmjet ekspertëve personel akademik të angazhuar në shërbimin e oponencave teknike, të kryhet sipas dispozitave të rregullores në fuqi.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 239/9 Prot.

Tiranë, më 20/06 /2024

V E N D I M

Nr. 20 datë 06.06.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË DO TË REALIZOHEN PËR
LËSHIMIN E VËRTETIMEVE NGA INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE NË ZBATIM
TË VKM – SË NR. 9, DATË 11.01.2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronjat a dhe c, neni 49, pika 1, shkronja ë, Vendimin nr. 9, datë 11.01.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, VKM Nr. 188, datë 13.03.2019, pika 3, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 32, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe në relacionin nr. 239/8 prot., datë 04.06.2024 të Administratorit të Institucionit;

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e shërbimeve që do të realizohen për lëshimin e vërtetimeve nga Instituti i Gjeoshkencave, në zbatim të Vendimit nr. 9, datë 11.01.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, sipas tipologjisë së trullit të objektit të ndërtimit, si më poshtë:
 - 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë me tvsh, për objekte shërbimi, industriale dhe bujqësore.
 - 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë me tvsh, për objekte civile deri në 3–kate.
 - 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë me tvsh, për objekte civile deri në 8–kate.
 - 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë me tvsh, për objekte me akses publik të një rëndësie të veçantë ose jetësore.
2. Të miratojë raportin e shpërndarjes së të ardhurave të realizuara sipas metodologjisë dhe përcaktimeve në relacionin bashkëlidhur.

3. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Instituti i Gjeoshkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1267/4 Prot.

Tiranë, më 06/06/2024

V E N D I M

Nr. 21 datë 06.06.2024

MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË BACHELOR, PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMEVE, SI DHE PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” DHE “MASTER PROFESIONAL”, PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 69, pika 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 52, pika 4, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 15, datë 17.05.2024 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 1267/3 prot., datë 20.05.2024 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë Bachelor, në programin e integruar të ciklit të dytë, si dhe në programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” për vitin akademik 2024 – 2025, në Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1797/Prot.
1

Tiranë, më 18/07/2024

V E N D I M

Nr. 22, datë 18/07.2024

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.16, DATË 17.7.2023 TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT PËR MIRATIMIN E NIVELEVE, KLASAVE DHE GRUPEVE
TË POZICIONEVE TË PUNËS, SI DHE MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE DHE SHITESAVE TË TJERA MBI PAGË TË PERSONELIT
ADMINISTRATIV DHE NDIHMËSAKADEMIK NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe 67, Vendimin nr. 422 datë 26.6.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr.326, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, Vendimin nr.13, datë 5.3.2024 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2023 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin nr.20, datë 25.9.2023 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026 të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 46, Vendimin nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin Administratorit të Institucionit nr. 1797prot., datë 16.07.2024,

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 16, datë 17.07.2023 “Për miratimin e niveleve, klasave dhe grupeve të pozicioneve të punës, si dhe miratimin e strukturës së pagave dhe shitesave të tjera mbi pagë të personelit administrativ dhe ndihmësakademik në Universitetin Politeknik të Tiranës”, shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1.Për natyrë të veçantë pune u jepet një shitesë mbi pagën bazë mujore punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të ndryshme, të përcaktuar në Klasën VII, të lidhjes nr.1, në masën 8000 (tetë mijë) lekë në muaj”;

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar sipas Vendimit nr.13, datë 5.3.2024 të Bordit të Administrimit “ *Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2023 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2024*”;
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2024.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Fatjon DHULI



Anëtar
Voltisa KOÇI



Anëtar
Arjan BEQIRAJ



Anëtar
Alfred PJETRI



Kryetar
Adriana RISTANI



Anëtar
Adrian NAÇO





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1094/Prot.
3

Tiranë, më 18/07/2024

V E N D I M

Nr. 23 datë 18.7.2024

P Ë R

MIRATIMIN E TARIFËS SË REGJISTRIMIT NË TESTIMIN E PRANIMIT NË
FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS, PËR VITIN AKADEMIK
2024 - 2025

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 1, shkronja ç, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, vendimin nr.31, datë 09.04.2022 të Dekanatit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, shkresat nr.123/3 prot., datë 26.04.2024 dhe shkresën nr. 123/4, datë 13.05.2024 të FAU, si dhe relacionin Nr.1094/2 Prot, datë 19.06.2024 të Administratorit të UPT, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e regjistrimit në testimin e pranimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës për vitin akademik 2024 – 2025 në vlerën:
 - 3500 (tre mijë e pesëqind) lekë
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Fatjon DHULI

Anëtar
Voltisa KOÇI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Adrian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1876/Prot.
2

Tiranë, më 25/09/2024

V E N D I M

Nr. 24, datë 25.09.2024

PËR

**RISHPËRNDARJEN E FONDEVE TË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË
STUDIMIT (DOUBLE DIPLOMA) ME UTC DHE UNIGE, NË CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE MASTER SHKENCOR NË INXHINIERI INFORMATIKE DHE
INXHINIERI ELEKTRONIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja b dhe c, neni 47, neni 49, pika 1, shkronja ë, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 1, Vendimin Qarkullues nr.29, datë 12.10.2022 “Detajimi i rishpërndarjes së fondeve buxhetore të akorduara për vitin 2022”, Vendimin Nr.13 datë 05.03.2024 “Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2023 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit Nr.1876/1, datë 20/09/2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për rishpërndarjen e fondeve buxhetore të programit të përbashkët të studimit (double diploma) me UTC dhe UNIGE, në ciklin e dytë të studimeve master shkencor në inxhinieri informatike dhe inxhinieri elektronike, si më poshtë:
 - **Pakësim** në zërin 600 (Shpenzime për pagesën orë mësimore/profesorëve të huaj), në vlerën 1,696,112 lekë;
 - **Shitesë** në zërin 606 (Shpenzime për bursa të studentëve), në vlerën 1,696,112 leke.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2206/1 Prot.

Tiranë, më 25/09 /2024

V E N D I M

Nr. 25 datë 25.09.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË KUOTAVE PER PROGRAMEN E PERBASHKËT TË
STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE NË INTELIGJENCË ARTIFICIALE DHE
OPTIMIZIM” PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025, NË FAKULTETIN E
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 69, pika 3, VKM Nr.41, date 24.01.2018, i ndryshuar, pika 2.7/c, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 52, pika 4, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 6, datë 10.09.2024 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 2206 prot., datë 16.09.2024 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë rialokimin e kuotave të paplotësura për programin e përbashkët të studimit “Master i Shkencave në Inteligjencë Artificiale dhe Optimizim” për vitin akademik 2024 – 2025, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2352 Prot.

Tiranë, më 25/09 /2024

V E N D I M

Nr. 26, datë 25.09.2024

P Ë R

**SHPËRNDARJEN E FONDEVE SHITESË NGA TË ARDHURAT DYTËSORE TË
REALIZUARA MBI PLANIFIKIMIN, NË ZËRIN SHPENZIME OPERATIVE
(ARTIKULLI 602), NË BUXHETIN E VITIT 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja a, neni 47, neni 49, pika 1, shkronja ë, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja e, Vendimin Nr. 13 datë 05.03.2024 “Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2023 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit Nr.1539/3, datë 20/09/2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërndarjen e fondeve shtesë nga të ardhurat dytësore të realizuara mbi planifikimin, në zërin shpenzime operative (artikulli 602) në buxhetin e vitit 2024, sipas tabelës 1 dhe 2 bashkëlidhur;
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2216/Prot.
14

Tiranë, më 25/09 /2024

V E N D I M

Nr. 27, datë 25.9.2024

P Ë R

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, MASTER PROFESIONAL NË INXHINIERINË E BURIMEVE MINERARE, PROFILI INXHINIERI MINERARE DHE PËRPUNIM MINERALES, NË FAKULTETIN E GJEOLOGJISË DHE TË MINIERAVE, UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja ç, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, shkronja A, pika 3/b, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 26, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 9, datë 17.09.2024 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 2116/1 prot., datë 19.09.2024 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

4. Të miratojë hapjen e ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare dhe Përpunim Minerale, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës, për vitin akademik 2025-2026;
5. Të miratojë propozimin për tarifën e studimit si poshtë:
 - Tarifa e rregjistrimit 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë;
 - Tarifa e shkollimit 156,000 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.
6. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 2353 Prot.

Tiranë, më 25/09 /2024

V E N D I M

Nr. 28, datë 25.09.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2025-2027 TË UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimin Plotësues Nr.4 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, paragrafi II, shkronja b; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr.8, datë 17.09.2024 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Projekt Buxhetin Afatmesëm 2025-2027 të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur;
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2646/11 Prot.

Tiranë, më 13 / 11 /2024

V E N D I M

Nr. 30, datë 13.11.2024

P Ë R

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE
“MASTER I SHKENCAVE” NË INXHINIERI MATEMATIKE NË
AKTUARISTIKË” NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE
INXHINIERISË FIZIKE, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin e Bordit të Administrimit Nr.25, datë 24.11.2023, Vendimin e Senatit Akademik Nr.20 datë 08.11.2024, si dhe relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave datë 11.11.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, për vitin akademik 2025 – 2026.
2. Tarifa totale e shkollimit për këtë program studimi është 168.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2929 Prot.

Tiranë, më 13 / 11 / 2024

V E N D I M

Nr. 31, datë 13.11.2024

P Ë R

**SHPËRNDARJEN E FONDEVE SHITESË NGA TË ARDHURAT DYTËSORE TË
REALIZUARA MBI PLANIFIKIMIN, NË ZËRIN SHPENZIME OPERATIVE
(ARTIKULLI 602), NË BUXHETIN E VITIT 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja a, neni 47, neni 49, pika 1, shkronja ë, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja e, neni 27, pika 1, Vendimin Nr. 13 datë 05.03.2024 “Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2023 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit nr.2742/2, datë 12/11/2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërndarjen e fondeve shtesë nga të ardhurat dytësore të realizuara mbi planifikimin, në zërin shpenzime operative (artikulli 602) në buxhetin e vitit 2024, sipas tabelës 1 dhe 2 bashkëlidhur;
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2928 Prot.

Tiranë, më 13/11 /2024

V E N D I M

Nr. 32, datë 13.11.2024

P Ë R

**DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË FORMË GRANT/TRANSFERTË E
PAKUSHTËZUAR PË VITIN 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika ç; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Vendimin Nr. 13 datë 05.03.2024 “Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2023 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin nr.22 datë 18.07.2024 të Bordit të Administrimit “Një shtesë në vendimin nr.16, datë 17.07.2023 të Bordit të Administrimit për miratimin e niveleve, klasave dhe grupeve të pozicioneve të punës, si dhe miratimin e strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të personelit administrative dhe ndihmës akademik në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”; shkresën nr. 6198/1 prot., datë 15.10.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr.2426/2 prot., datë 18.10.2024,

V E N D O S I:

1. Detajimin e fondeve të akorduara për vitin 2024 në shumën 3,413,200 (tre milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e dyqind) lekë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi në zërat:

-600 (paga të punonjësve)

-601 (sigurime shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve)

2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2395/12 Prot.

Tiranë, më 13/11 /2024

V E N D I M

Nr. 33, datë 13.11.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR TË AUDITIT TË BRENDSHËM
NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR PERIUDHËN 2025– 2027**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 116, pika 1, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja l, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 2395/1 prot, datë 02.10.2024 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës, për periudhën 2025 - 2027, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2633/14 Prot.

Tiranë, më 13 / 11 /2024

V E N D I M

Nr. 34, datë 13.11.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E AKTIVIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME NUMËR
STUDENTËSH MË PAK SE DHJETË NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE DHE NË FAKULTETIN
E GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, neni 107, shkronja c, Vendimin nr. 386, datë 01.06.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 27, pika 7, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr.33, datë 21.10.2024 i Dekanatit të FIMF, vendimin nr. 9, datë 16.10.2024 të Dekanatit të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, vendimin e Senatit Akademik nr.16, datë 22.10.2024, si dhe shkresën nr. 2633/3 prot. datë 24.10.2024 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për aktivizimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemeshe” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me numër studentësh më pak se 10 (dhjetë), për vitin akademik 2024-2025.
2. Të miratojë propozimin për aktivizimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, me numër studentësh më pak se 10 (dhjetë), për vitin akademik 2024-2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2972/6 / Prot.

Tiranë, më 26/11 /2024

V E N D I M

Nr. 35, datë 26.11.2024

PËR

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE,
BACHELOR NË INXHINIERI MATEMATIKE DHE DATA SCIENCE, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE,
PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin e Senatit Akademik Nr.24 datë 20.11.2024, si dhe shkresën e Rektorit nr.2972/3, datë 20.11.2024 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Inxhinieri Matematike dhe Data Science”, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, për vitin akademik 2025 – 2026;
2. Tarifa shkollimit për këtë program studimi është 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 844 / Prot.

Tiranë, më 26/11 /2024

V E N D I M

Nr. 36 , datë 26.11.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË
NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 116, pika 1, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja l, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr.844/10 prot, datë 17.9.2024 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të auditimit të përputhshmërisë në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, sipas dokumentit të paraqitur nga Sektori i Auditimit të Brendshëm;
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3210 Prot.

Tiranë, më 18/12 /2024

V E N D I M

Nr. 37, datë 18.12.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”, NË ARKITEKTURË DHE
URBANISTIKË, ME NËNFUSHË “ARKITEKTURË DHE DIZAJN”, NËNFUSHË
“TRASHËGIMI DHE TEKNOLOGJI ARKITEKTURE”, DHE NËNFUSHË
“URBANISTIKË”, SI DHE MIRATIMIN E PROJEKTIT KËRKIMOR-
SHKENCOR “ARKITEKURA DHE QYTETI”, NË FAKULTETIN E
ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr.41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.1 datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në UPT, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin e Senatit Akademik nr.25, datë 11.12.2024 dhe shkresën nr. 3159/3 prot. datë 11.12.2024 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”, në Arkitekturë dhe Urbanistikë, me nënfushë “Arkitekturë dhe Dizajn”, nënfushë “Trashëgimi dhe Teknologji Arkitekture”, dhe nënfushë “Urbanistikë”, si dhe miratimin e projektit kërkimor-shkencor “Arkitekura dhe Qyteti”, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës.
2. Të miratojë tarifën e shkollimit për studentët që nuk janë personel akademik me kohë të plotë, në shumën 380,000 (treqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3207/Prot.
1

Tiranë, më 18/12 /2024

V E N D I M

Nr. 38, datë 18.12.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E BURSIVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA
VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË
PROGRAM TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" DHE PROGRAM TË
INTEGRUAR TË STUDIMEVE, TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET E
PËRCAKTUARA, PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "*Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit*", të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "*Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë*", të ndryshuar, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 "*Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës*", si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 3207 prot., datë 13.12.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë Bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët kanë aplikuar gjatë vitit akademik dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2024-2025, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për studentët të cilët kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar për bursë financiare gjatë vitit akademik 2024-2025, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.


3. Ky vendim t'i njoftohet MAS dhe AKFAL, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universiteti Politeknik të Tiranës për vitin 2025.
4. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe njësitë kryesore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 790/3 Prot.

Tiranë, më 16/4 /2024

V E N D I M

Nr. 17, datë 16.04.2024

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE” ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja c, Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkolimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 26, pika 3, si dhe vendimin nr. 11, datë 28.03.2024 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2024 – 2025, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” me kohë të plotë, për vitin akademik 2024 – 2025 sipas tabelave nr. 2, 3 dhe 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentët në masën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.
4. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

5. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli i parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2024 - 2025.
6. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të studimit, do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2024 – 2025.
7. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe programin e integruar të studimeve, kryhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit.
8. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, kryhet e ndarë në 2 (dy) këste. Kësti i parë të paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit dhe kësti i dytë paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të verës.
9. Në situata objektive që e bëjnë të pamundur respektimin e afateve të përcaktuara për pagesën e tarifës së shkollimit, njësitë kryesore të kenë mundësi veprimi për metodologjinë dhe afatet e pagesave.
10. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 942/ Prot.

Tiranë, më 16/04 /2024

V E N D I M

Nr. 16, datë 16.04.2024

P Ë R

MIRATIMIN E BURSIVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE, SI DHE MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË ME NOTË MESATARE 6 (GJASHTË) E LARTË DHE STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" E "MASTER I SHKENCAVE", PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë" Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës".

VENDOSI:

Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët kanë aplikuar apo janë gjeneruar nga sekretaritë mësimore gjatë vitit akademik dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2023 - 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2023 – 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur.
3. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë bachelor ose në programin e integruar të studimeve, të cilët plotësojnë kriterin e notës mesatare 6 (gjashtë) e lartë, për vitin akademik 2023 – 2024, sipas relacionit dhe listës bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Për studentët të cilët kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar për bursë financiare gjatë vitit akademik 2023 – 2024, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.
5. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI

[Firma e Kryetarit]



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 577/1 Prot.

Tiranë, më 05 / 03 /2024

V E N D I M

Nr. 14 datë 05.03.2024

P Ë R

**DETAJIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE TË AKORDUARA
PËR VITIN 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresat nr. 1281/1 prot., datë 21.02.2024 dhe nr. 2123/1 prot., datë 22.02.2024 të Ministrisë së Financave “Dërgohet detajimi i grantit për vitin 2024”, si dhe relacionin nr. 577 prot., datë 05.03.2024 të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë detajimin e shpërndarjes së fondeve buxhetore të akorduara për vitin 2024 në njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, në zërin:
 - 606 (shpenzime për mbështetjen financiare në masën sa paga minimale në shkallë vendi të studentëve që ndjekin një program prioritar dhe studentëve ekselentë).
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 474/5 Prot.

Tiranë, më 05/03 /2024

V E N D I M

Nr. 13 datë 05.03.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 22, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe vendimin nr. 6, datë 29.02.2024 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2023.
2. Të miratojë raportin e detajuar të buxhetit të konsoliduar për vitin 2024, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 421/1 Prot.

Tiranë, më 22/02/2024

V E N D I M

Nr. 10, datë 22.02.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E TARIFËS SË REGJISTRIMIT DHE TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR “SIGURIA DHE
SHËNDETI NË PUNË”, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 4, datë 02.02.2024 të Senatit Akademik, shkresën nr. 87/2 prot., datë 06.02.2024 të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 421 prot., datë 19.02.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit për programin e studimit të formimit të vazhduar “Siguria dhe Shëndeti në Punë” në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, si më poshtë:
 - Tarifa e regjistrimit 1000 (njëmijë) lekë.
 - Tarifa e shkollimit 120,000 (njëqind e njëzetë mijë) lekë.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 420/1 Prot.

Tiranë, më 22 / 02 /2024

V E N D I M

Nr. 09 datë 22.02.2024

P Ë R

MIRATIMIN E TARIFAVE PËR KRYERJEN E E ANALIZAVE LABORATORIKE TË MATERIALIT TË TEKSTILIT DHE LËKURËS, TË OFRUARA NGA FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr. 91/1 prot., datë 06.02.2024 të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike për rishikimin e tarifave për shërbimin e analizave laboratorike të ofruara nga ky fakultet, si dhe relacionin nr. 420 prot, datë 19.02.2024 të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat për shërbimin e analizave laboratorike të materialit të tekstilit dhe lëkurës, të ofruara nga Laboratori i akredituar Fiziko – Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike si më poshtë:
 - Analiza për materialin e tekstilit 2000 (dymijë) lekë pa tvsh për 1 (një) testim;
 - Analiza për materialin e lëkurës 2800 (dymijë e tetëqind) lekë pa tvsh për 1 (një) testim;
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 419/ Prot.
1

Tiranë, më 22 / 02 /2024

V E N D I M

Nr. 08, datë 22.02.2024

PËR

MIRATIMIN E BURSIVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE, SI DHE MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË ME NOTË MESATARE 6 (GJASHTË) E LARTË DHE STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” E “MASTER I SHKENCAVE”, PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 419 prot., datë 19.02.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë Bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët kanë aplikuar gjatë vitit akademik dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2023 - 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2023 – 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur.
3. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë bachelor ose në programin e integruar të studimeve, të cilët plotësojnë kriterin e notës mesatare 6 (gjashtë) e lartë, për vitin akademik 2023 – 2024, sipas relacionit dhe listës bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Për studentët të cilët kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar për bursë financiare gjatë vitit akademik 2023 – 2024, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.
5. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 152/2 Prot.

Tiranë, më 23/01 /2024

V E N D I M

Nr. 06, datë 23.01.2024

PËR

**MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE TË PUNËS TË KRYERA JASHTË KOHËS
NORMALE TË PUNËS DHE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR, NGA PUNONJËSET E
SEKREtarIVE MËSIMORE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja ë, Udhëzimin nr. 12, datë 30.06.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, Urdhrin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2023-2024”, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Urdhrin nr. 46 datë 25.07.2023 të Rektorit të UPT – së “Për ndryshimin e orarit të punës të Sekretarive Mësimore gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 151 prot., datë 22.01.2024, Bordi i Administrimit i UPT-së,

VENDOSI:

2. Të miratojë pagesën e orëve të punës të kryera jashtë kohës normale të punës dhe në ditët e pushimit javor nga punonjëset e sekretarive mësimore në periudhën shtator – tetor 2023, për procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve fitues në vitin akademik 2023 – 2024 në Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas relacionit të administratorit dhe dokumentacionit shoqërues bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Efekti financiar në shumën 1,705,400 (një milion e shtatëqind e pesë mijë e katërqind) lekë të përballohet nga fondet në dispozicion për vitin 2024.
4. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 154/1 Prot.

Tiranë, më 23/01 /2024

V E N D I M

Nr. 05 datë 23.01.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E ULJES SË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%,
PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË
PARË BACHELOR OSE NË PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMEVE, TË
CILËT PLOTËSOJNË KRITERIN E NOTËS MESATARE 6 (GJASHTË) E LARTË,
PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar me VKM-në nr. 778, datë 26.12.2018, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 154 prot., datë 22.01.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë bachelor ose në programin e integruar të studimeve, të cilët plotësojnë kriterin e notës mesatare 6 (gjashtë) e lartë, për vitin akademik 2023 – 2024, sipas relacionit dhe listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t’i njoftohet MAS dhe AKFAL, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2024.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT
KRYETAR
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 153/1 Prot.

Tiranë, më 23/01 /2024

V E N D I M

Nr. 04, datë 23.01.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E ULJES SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN 50% PËR
STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË
DYTË “MASTER I SHKENCAVE” DHE “MASTER PROFESIONAL” PËR VITIN
AKADEMIK 2023 – 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 153 prot., datë 22.01.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2023 – 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur.
2. Ky vendim t’i njoftohet MAS dhe AKFAL, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2024.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 154/ Prot.
1

Tiranë, më 23 / 01 / 2024

V E N D I M

Nr. 03 , datë 23.01.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E BURSIVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA
VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË
PROGRAM TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE PROGRAM TË
INTEGRUAR TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 154 prot., datë 22.01.2024, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë Bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2023 - 2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për studentët që kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar për bursë financiare gjatë vitit akademik 2023 – 2024, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.

3. Ky vendim t'i njoftohet MAS dhe AKFAL, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2024.

4. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 155/1 Prot.

Tiranë, më 23/01/2024

V E N D I M

Nr. 2, datë 23.01.2024

PËR

**MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT FINANCIAR TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE
PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 834, datë 28.12.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 929 datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 155 prot., datë 22.01.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërblimin financiar për punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, të cilët paguhen me klasën e VII në Universitetin Politeknik të Tiranës në masën:
 - 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Efektet financiare të përballohen nga të ardhurat e institucionit të vitit 2023.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për kryerjen e veprimeve financiare deri në datën 25 janar 2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI

